

angazhuar në shtabin lokal të UÇK-së. Forcat serbe e kanë sulmuar fshatin për herë të dytë më 1.09.1998. Hatmonja, Ferati dhe e reja me fëmijët u strehuan në bodrumin e shtëpisë së djalit tjetër Hidajetit. Ditën tjetër, më **2.09.1998**, forcat serbe arritën deri te fshati. Rreth orës 16:00, civilët i braktisën shtëpitë e veta dhe, në formë të kolonës, u nisën drejt fshatit Poslishtë/Poslište. Hatmonja e moshëthyer ecte ngadalë me një mike, në fund të kolonës. Përderisa po kalonin në afërsi të shkollës së fshatit [**Hoçë e Qytetit/Hoça Zagradaska**] dhe pranë lumit, afër tyre ka eksploduar një predhë. Ciflat e saj e kanë qëlluar Hatmonen në kokë, duke e lënë të vdekur në vend. Mikja e saj ka ikur me vrap dhe, më vonë, e ka njoftuar familjen. Të nesërmen, vajza Fiqrija me disa familjarë shkuan me traktor dhe e morën trupin e Hatmones. E varrosën në varrezat e qytetit.

Burimet: deklarata M.S, FDH-35607; deklarata I.K, FDH-9223; deklarata Z.B, FDH-2740; deklarata A.K, FDH-2741.

Xhemil (Nezir) Krasniqi

(1.07.1950, shqiptar nga Hoça e Qytetit/Hoça Zagradaska, komuna e Prizrenit/Prizren, bujk, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Xhemili ka qenë pjesëtar i njësitit të UÇK-së *Vërrini*, i cili vepronte në zonën operative të *Pashtrikut/Paštrik*. Detyra e tij ishte informimi i popullatës civile për lëvizjet e forcave serbe. Në datën **2.09.1998**, ai ka shkuar në **Hoçën e Qytetit/Hoça Zagradaska**, për të alarmuar popullatën për sulmin e mundshëm të forcave serbe. Në ato çaste, forcat serbe kanë filluar bombardimin e fshatit. Një predhë ka rënë në qendër të fshatit, ku rastisi të ishte Xhemili. Ciflat e saj e kanë qëlluar në këmbë. Pas pak, ndërroi jetë. Banorët e kanë futur trupin e tij në shtëpinë e Arif Bytyqit dhe, pastaj, u larguan nga fshati për shkak të bombardimeve të njëpasnjëshme. Pas dy ditësh, i biri, së bashku me disa banorë të fshatit, u kthye dhe e varrosi të atin në varrezat e Hoçës së Qytetit/Hoça Zagradaska. Në datën 15.09.1999, familjarët i kanë rivarrosur mbetjet mortore të Xhemilit në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës,

në Landovicë/Landovica.

Burimet: deklarata I.K, FDH-9223; deklarata Z.B, FDH-2740; deklarata A.K, FDH-2741; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Merxhan (Izeir) Shala

(23.04.1925, shqiptar nga Jeshkova/Ješkovo, komuna e Prizrenit/Prizren, pensionist)

Para se të shkonte në pension, Merxhani punonte në fabrikën e ngjyrave *Duga* në Beograd, ku jetonte me bashkëshorten Floken. Pas vdekjes së saj, ai u kthye në fshatin e lindjes së Jeshkovës/Ješkovo. Jetonte me familjen e të vëllait Mestanit. Në datën **2.09.1998**, kur UJ dhe policia serbe filluan sërish me bombardimin e **Jeshkovës/Ješkovo**, Mestani me familje u strehuan në pyll, ndërkaq Merxhani ndenji në shtëpi. I tha të vëllait se ishte në moshë, e kishte letërnjoftimin serb dhe e fliste mirë serbishten. Nuk besonte se ushtarët dhe policët serb do t'i bënin diçka të keqe. Pasdite, djali i vëllait të Merxhanit, Sejrani, u kthye në fshat. E ka gjetur trupin e pajetë të Merxhanit në rrugën kryesore të fshatit. Njëpër tërë trupin i kishte vrimat nga plumbat dhe ishte i shkelur me tank. Sejrani e ka mbështjell trupin e axhës me një batanije dhe e ka lënë pranë rrugës. Në datën 5.09.1998, banorët dhe ushtarët e UÇK-së e kanë varrosur Merxhanin në varrezat e fshatit.

Burimet: deklarata S.S, FDH-20576; deklarata F.B, FDH-2545; deklarata N.S, FDH-2547.

Bajram (Murat) Thaqi

(4.06.1963, shqiptar nga Lubiçeva/Ljubiçevo, komuna e Prizrenit/Prizren, bujk, pesë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Në datën **2.09.1998**, forcat serbe e sulmuan Lubiçevën/Ljubiçevo. Banorët ikën nga fshati dhe u strehuan në pyllin e afërt. Pjesëtarët e UÇK-së, po ashtu, gjendeshin në pyll. Kur dëgjoji se ushtria serbe u tërhoq nga fshati, Bajrami u nis për në shtëpi [**Lubiçevën/Ljubiçevo**]. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e shihnin të gjallë. Trupin e Bajramit e kanë gjetur komshinjtë e tij më 12.09.1998, në shtëpinë e tij të rrënuar. E kanë varrosur në të njëjtin ditë në varrezat e fshatit. Pas luftime, më